

INCOTERMS 2000

Rregullat ndërkombëtare për komentim
të termave të tregtisë së jashtme



Dogana e Kosovës
Bulevardi Bill Clinton p.n.
Prishtinë, Republika Kosovës,
Tel. 038 540 350
Fax. 038 540 836
email: hq@dogana-ks.org
www.dogana-ks.org



INCOTERMS 2000

Rregullat ndërkombëtare për komentim
të termave të tregtisë së jashtme

-
- Përgatitur nga: Zyhdi Axhemi
 - Departamenti i Këshillave Ligjore
 - Dogana e Kosovës
-

INCOTERMS 2000

RREGULLAT NDËRKOMBËTARE
PËR KOMENTIM TË TERMAVE TË
TREGTISË SË JASHTME



Përmbatja ■

■ INCOTERMS - hyrje	7
■ Struktura e incotermsave	9
■ Termat, kuptimi dhe komentimi	15
■ Pikëkalimet e autorizuara	43
■ Kontaktet	45



INCOTERMS 2000

Dallimet në praktikën tregtare përkitazi me komentimet e rregullave zakonore në vendet e ndryshme të botës kanë sjell nevojën e definimit të termave të cilat përdoren në tregtinë e jashtme. Shif për këtë OEN (Oda Ekonomike Ndërkombtare) që nga versioni i parë mbi "INCOTERM" at radhazi disa herë ka bërë revizionimin e tyre. Këto paraqesin një përmbledhje të rregullave ndërkombtare që përdoren në afarizmin tregtar me botën e jashtme, para se gjithash të përcaktimi i pariteteve të kontratave mbi transportin dhe sigurimin ndërkombtar të mallrave. Andaj komentimi i unifikuar i këtyre termave eviton mundësinë e komentimeve të lloj llojshme në vende të ndryshme duke sjellë deri te mos marrëveshtjet dhe kontestet ndërmjet palëve kontraktuese e që konsistojnë në humbje të kohës dhe parasë.

Incoterms-at kanë të bëjnë me marrëdhëniet në mes të blerësit dhe shitësit në bazë të kontratës së shitëblerjes. Meqë nuk i definojnë të gjitha modalitetet e transakcionit të tregtisë së jashtme, por vetëm qështjet themelore të cilat ndërlidhen me elementet qenësore të kontratës së shitëblerjes në njërin anë dhe në kombinim me kontratat tjera të cilat janë të domosdoshme për realizimin e veprimit të caktuar në tregtinë e jashtme siq janë kontratat mbi transportin, sigurimin, dhe finansimin në anën tjetër.

Duke pasë parasysh që egzistojnë disa versione të Incoterma-ve siq përmendëm më parë, me rastin e përdorimit të tyre patjetër duhet theksohet versioni konkret që është përdorur (psh. "Incoterm-at 2000").

Shpeshherë në praktikë ndodhë që palët kontraktuese me dëshirë që t'i precizojnë termat e caktuara nga Incoterm-at vetë termit ia shtojnë edhe disa fjalë. Incoterm-at nuk përmbajnë kurrfar udhëzimesh mbi këto ndajshitesa, andaj këto janë burim i mosmarrëveshtjeve dhe bijnë ndesh me funksionin kryesor të Incoterm-ave.

Mu për këtë çdo term i shtuar përbri Incoterm-it duhet që posaçërisht dhe në mënyrë precise të sqarohet me kontratë. Në qoftë se është i nevojshëm ndonjë precizim tjetër shtesë, duhet patjetër të përdorën shprehjet nga Konventa e KB mbi kontratat e shitëblerjes ndërkombtare të mallrave (CSIG) të 1980. Palët kontraktuese që dëshirojnë t'i evitojnë mosmarrëveshtjet që mund të lindin nga marrëdhënjet e tilla ndërkombtare mund t'i drejtohen Arbitrazhit të OEN.



STRUKTURA E INCOTERM-ave

Me qëllim të të kuptuarit dhe gjeturisë më të mirë të gjithë termat mbi paritetet nga Incoterm-at e vitit 2000 janë të grupuar në katër kategori, sipas shkronjës së parë nga e cila është emërtuar termi:

Grupi	Shkurtesa	Dmth.e shkurt.	Lloji I transportit
E Nisja	EXW	FRANKO FABR. (vendi i kontrakt...)	Çfardo lloji i transp.
F Transporti kryesor nuk është i paguar	FCA	FRANKO TRANSP. (vendi i kontrakt...)	Çfardolloji i transp.
	FAS	FRANKO përbri ani jes(limani i kontrakt i livrimit)	Vetëm transp.ujor
	FOB	FRANKO në anije (limani i kontrakt.i (destinimit)	Vetëm transp.ujor
C Transporti kryesor i paguar	CFR	Çmimi me transport (limani i kontrakt.i i destinimit)	Vetëm transp uJOR
	CIF	Çmimi me sigurim dhe transport(...limani i kontraktuar i dest.)	Vetëm transp. uJOR

STRUKTURA E INCOTERM-ave

Grupi	Shkurtesa	Dmth.e shkurt.	Lloji I transportit
	CPT	Transp.i paguar deri (...limani i kontrakt. i destinimit)	Çfardo lloji i transp.
	CIP	Transp.dhe sig.të paguar deri (...limani i destinimit)	Çfardo lloji i transp.
D	DAF	I livruar në kufi (...vendi i kontraktuar)	Çfardo lloji i trans.
Arritja	DES	I livruar franko anije (...limani i kontraktuar i destinimit)	Vetëm transp.ujor
	DEQ	I livruar franko breg det (...limani I kontr i destinimit)	Vetëm transp.ujor
	DDU	I livruar i pa zhdog. (...vendi i përcaktuar sipas kontratës)	Çfardo lloji i trans.
	DDP	I livruar dhe i zhdog. (...vendi i përcaktuar sipas kontratës)	Çfardo lloji i trans.

Në kuadrin e grupimeve të përshkruara më lartë obligimet e palëve kontraktuese janë të klasifikuara në 10 tituj, me të cilin rast çdo titull në anën e shitësit njëkohësisht paraqet pozicionin e blerësit në aspektin e që po e shtjellojmë. Këto janë:

- A Obligimet e shitësit
- A1 Sigurimi i mallit në përputhje me kontratën
- A2 Lejet, pëlqimet, dhe formal. tjera
- A3 Kontratat mbi transp. dhe sigurimin
- A4 Livrimi i mallit
- A5 Bartja e rrezikut
- A6 Ndarja e shpenzimeve
- A7 Lajmërimi i blerësit
- A8 Prova mbi dërgesën, dok. i transp. ose porosia përkatëse elektronike
- A9 Verifikimi, ambalazhi, shenjzimi
- A10 Obligime të tjera



- B - Obligimet e blerësit
- B1 Pagesa e çmimit
- B2 Lejet, pëlqimet dhe formal. tjera
- B3 Kontratat mbi transp. dhe sigur.
- B4 Pranimi i mallit
- B5 Bartja e rrezikut
- B6 Ndarja e shpenzimeve
- B7 Lajmërimi i shitësit
- B8 Provë mbi dërgesën, dok. i transportit ose porosia përkatëse elektronike
- B9 Kontrolli i mallit
- B10 Obligime të tjera

TERMA

EXW EX
WORKS
(...named
place)

KUPTIMI

FRANKO
FABRIKA
(...vendi i
kontraktuar)

KOMENTIMI

Shitësi e ka livruar mallin në çastin e vendosjes së tij në hapësirat e veta ose në vendin e kontraktuar (p.sh. në repart të fabrikës etj.) të pa zhdoguar në eksport, të pa ngarkuar, në disponim blerësit.

Ky term paraqet obligimin minimal të shitësit, shpenzimet dhe rreziqet për nxjerrjen e mallit nga hapësirat e shitësit i bartë blerësi.

Nëqoftë se palët kontraktuese dëshirojnë që shpenzimet dhe rreziqet t'i bartë shitësi para livrimit dhe ky formulim duhet posaçërisht të futet në kontratë.

Ky term nuk duhet të përdoret kur blerësi drejtëpërdrejtë ose tërthorazi nuk mund t'i kryen formalitetet e eksportit. Në këtë rast duhet të përdoret terma "FCA" nëqoftëse shitësi pajtohet ta kryen ngarkimin në rrezik. Dhe shpenzime të veta.

EXW Ex works

Loading
location



TERMA


FCA FREE
CARRIER
(...named place)

KUPTIMI

FRANKO
FABRIKA
(...vendi i
kontraktuar)

KOMENTIMI

Shitësi ia livron mallin e zhdoganuar në eksport transportuesit të emëruar me kontratë nga ana e shitësit.
Mund të përdoret për të gjitha mjetet transportit, duke e inkorporuar edhe atë multimodal.
Me nocionin “transportues” këtu nënkuptohet çdo person i obliguar me kontratë që ta kryej transportin ose ta siguroi atë hekurudhor, rrugor, ajror, detar, përmes lumenjëve ose në kombinim të këtyre mjeteve transportuese. Në qoftë se blerësi e cakton personin për pranim të mallit i cili nuk është njëkohësisht edhe transportues, konsi derohet që shitësi e ka kry obligimin E tij në rastin e dorëzimit të mallit personit në fjalë.



FCA



TERMA

FAS FREE
ALONGSIDE
SHIP
(...named port
of shipment)

KUPTIMI

FRANKO PËRBRI
ANIJES
(...limani i kontraktuar
i livrimit)


KOMENTIMI

Shitësi e ka përmbushur obligimin mbi livrimin e mallit kur ate e ka vendosur përmbri anijes në limanin e kontraktuar të livrimit. Nga ky moment të gjitha shpenzimet dhe rreziqet për humbje ose dëmtim të mallit ka lojnë te blerësi.

Shitësi e zhdoganon mallin eksportues, përndryshim nga verzionet e mëpa rëshme të INCOTERM-ave kur ai vetëm e ka organizuar transportin. Në të kundërtën nëqoftëse palët kontr. dakordohen që shitësi ti kryen formalitetet e eksportit kjo duhet të konstatohet me kontratë në mënyrë të qartë.

Ky term përndryshe mund të përdoret vetëm në qarkullimin detar ose në lumenj.

Shitësi Transportuesi Kufiri Porti Porti Dogana Blerësi



FAS

TERMA

FOB FREE ON BOARD
(...named port of shipment)


KUPTIMI

FRANKO ANIJE
(...limani i kontr. i livrimit)

KOMENTIMI

Shitësi e ka livruar mallin në çastin e vendosjes përtej rrethojës së anijës në limanin e kontraktuar të livrimit. Nga ky moment, blerësi i bartë të gjitha shp ezimet dhe rreziqet për humbje ose dëmtime të mallit.

Shitësi e zhdoganon mallin në export. Nëqoftëse palët kontraktuese nuk e kanë paraparë me kontratë që malli të livrohet përtej rrethojës së anijës duhet të përdoret termi FAC. Përdoret vetëm në qarkullimin detar dhe të lu menjëve.



TERMA

CFR COST AND
FREIGHT
(...named port of
destination)


KUPTIMI

ÇMIMI ME
TRANSPORT
(...limani i kontraktuar
i destinimit)

KOMENTIMI

Shitësi e përmbush obligimin në çastin e vendosjes së mallit përtej rrethojës së anijes në limanin e kontraktuar të livrimit.
Shitësi obligohet t'i bartë shpenzimet e transportit deri te porti i destinacionit. Të gjitha shpenzimet lidhur me humbje dhe dëmtim të mallit nga çasti i dorëzimit të mallit në limanin e destinimit, prej shitësit kalojnë në blerësin.

Shitësi e zhdoganon mallin eksportues. Ky term përdoret vetëm në qarkullimin detar dhe nëpër lumenjë. Në qoftëse nuk është kontraktuar vendosja e mallit përtej rrethojës së Anijes përdoret termi CPT.



CFR

TERMA

CIF COST,
INSURANCE
AND FREIGHT
(...named port
of destination)

KUPTIMI

TRANSPORTI DHE
SIGURIMI
JANË PAGUAR DERI
(...limani i kontraktuar
i destinimit)

KOMENTIMI

Shitësi i mallit e ka livruar mallin në momentin e vendosjes përtej rrethojës së anijës, në limanin kontraktues të livrimit.

Shitësi është i obliguar t'a paguaj çmimin e transportit deri te limani i kontraktuar i destinimit. Të gjitha shpenzimet dhe rreziqet në lidhje me livrimin, kalojnë nga shitësi te blerësi.

Shitësi obligohet t'a bëjë sigurimin kundër rrezikut të dëmtimit të mallit gjatë transportit detar, për këtë paguan edhe shpërblimin (preminë) e Sigurimit.

Shitësi është i obliguar t'a siguroi vetëm çmimin minimal të sigurimit, në rast se blerësi dëshiron mbulesë të plotë duhet ta kontraktoi qartë këtë çështje me shitësin e pastaj të bëjë aranzhman plotësues për sigurim. Shitësi e zhdoganon mallin eksportues.

Termi në fjalë përdoret vetëm në qarkullimin detar dhe nëpër lumenjë. Kur palët kontrakt. nuk e precizojnë vendosjen e mallit përtej rrethojës së anijës do të përdoret termi CIP.

Shitësi Trasportuesi Kufiri Porti Porti Dogana Blerësi



CIF

TERMA

CPT CARRIAGE
PAID TO
(...named place
of destination)

KUPTIMI

TRANSPORTI
I PAGUAR DERI
(...limani i
kontraktuar i dest.)

KOMENTIMI

Shitësi ia livron mallin transportuesit të cilin e ka përcaktuar duke ia pag. shp.e transp. deri te vendi i kontrakt. Blerësi i bartë të gjitha shpenzimet dhe rreziqet e parapara në këtë mënyrë, pas lëvrimit të mallit nga ana e shitësit. Në qoftë se bartja e mallit kalon përmes disa transportuesve, rreziku nga shitësi kalon te transportuesi i parë të cilit i është livruar malli.

Nocioni “transportues” në këtë rast nënkupton çfarëdo personi i cili është obliguar me kontratë të transp. hekur. rrugor, ajror, detar ose lumenjësh ose në kombinim të llojeve të përmendura të transportit.

Shitësi e zhdog mallin në eksport. Mund të shfrytëzohen të gjitha mjetet e transportit duke përfshirë edhe atë multimodal.

Shitësi Transportuesi Kufiri Porti Porti Dogana Blerësi



CPT

TERMA

CIP CARRIAGE
AND
INSURANCE
PAID TO
(...named place of
destination)

KUPTIMI

TRANSPORTI
DHE
SIGURIMI
TË PAGUARDERI
(...limani i kontrakt.
i destinimit)

KOMENTIMI

Shitësi ia livron mallin transportuesi të cilin e ka përzgjedhur vetë njëherit ia paguan shpenzimet e transportit për dërgim të mallit deri te vendi i përcaktuar me kontratë dhe paguan preminë e sigurimit për rrezikun e blerësit nga humbja ose dëmtimi i mallit për tërë kohëzgjatjen e transportit. Ky obligim i shitësit parashihet ta siguroi mbulesën minimale të sigurimit. Në qoftë se blerësi dëshiron një shkallë më të lartë të mbulimit me garancion, duhet që këtë shprehimisht me e kontraktu me shitësin ose të bëjë aranzhman plotësues për sigurim. Shitësi e zhdoganon mallin eksportues.

Terma "transportues" nënkupton çdo person i cili me kontratë të transportit është obliguar ta bëjë vet ose siguroi transportin me hekurudhë, rrugor, ajror, detar, të lumenjëve ose në kombinim të këtyre llojeve të transportit. Në rastin kur deri te vendi i përcaktuar me kontratë shfrytëzohen Disa transportues, rreziku kalon në blerësin kur malli është dorëzuar te transportuesi i parë. Ky term mund të përdoret të gjitha llojet e transportit duke e përfshirë edhe atë multi modal.



TERMA

DAF
DELIVERED AT
FRONTIER
(...named place)

KUPTIMI

LIVRUAR
NË KUFİ
(...vendi i
kontraktuar)

KOMENTIMI

Konsiderohet që shitësi ka bërë livrimin kur mallin e pa shkarkuar të zhdoganuar në eksport dhe të pazhdoganuar në import, ia ka lënë në dispozicion të lirë blerësit në mjetin transportues në vendin dhe kufirin e destinimit, por para kalimit të vijës doganore të vendit fqinj.

Në qoftë se palët kontraktuese dakordohen me kontratë të shitëblerjes që blerësi të jetë përgjegjës për shkakimin e mallit në vendin e destinimit dhe t'a bartë mbi vedit rrezikun dhe shpenzimet e shkarkimit, kjo duhet të kontraktohet çartë në kontratën e shitëblerjes.

Termi në fjalë përdoret pa marrë parasysh llojin e transportit në rastin kur malli livrohet në kufirin tokësor. Në rastin kur livrimi bëhet në limanin e caktuar, në kuvertë të anijes ose në skele të bregut të detit, duhet të shfrytëzohet pariteti me termën DES ose DEQ.



TERMA

DES
DELIVERED
SHIP
(...named port
of destination)

KUPTIMI

LIVRUAR
FRANKO
ANIJE
(limani i kontrakt.
i destinimit)

KOMENTIMI

Shitësi e ka livruar mallin e pa zhd. nuar në import, duke ia lënë në disponim të lirë blerësit në anije, në limanin e destinimit. Shitësi e zhdoganon mallin në eksp. ort ndërsa blerësi në import. Shitësi ka obligim të bartjes së të gjitha shpenzimeve dhe rreziqeve për livrim të mallit deri te limani i destinimit para shkarkimit. Në qoftë se palët dakordohen që shpenzimet dhe rreziqet të bijnë mbi blerësin në këtë rast duhet të përdoret pariteti Me termin DEQ.

Shitësi Trasportuesi Kufiri Porti Porti Dogana Blerësi



TERMA

DEQ
DELIVERED
EX QUAY
(...named port
of destination)

KUPTIMI

LIVRUAR
FRANKO
BREGUI DETIT
(...limani i
destinimit)


KOMENTIMI

Shitësi e ka livruar mallin në çastin kur blerësit ia ka lënë në disponim të lire, të pazhdoganuar në import në bregun e detit (skele) në limanin e kontraktuar.

Shitësi është i obliguar t'i bart shpenzimet dhe rreziqet lidhur me livrimin e mallit deri në limanin e kontraktuar të destinimit si dhe shkarkimin e tij në bregun e detit (skele). Blerësi e zhdoganon mallin në import dhe i paguan të gjitha shpenzimet lidhur me formalitetet adm., doganën tatimin dhe tagrat tj. importuese. Këtu është ndryshimi në raport me verzionet e mëparshme të INCOTERM-ave kur shitësi ishte i obliguar t'a organizoi zhdoganimin në im Port.

Në qoftë se palët kontraktuese pajtohen që shitësi t'i bart të gjitha shpenzimet që Paguhën me rastin e zhdog. të mallit në import, ose një pjesë të atyre shpenzimeve, këtë do të duhej ta kishin sqaruar shprehimisht me kontratë. Mund të përdoret vetëm kur malli livrohet nëpër dete dhe lumenj, si dhe me transport multimodal me zbakimin nga anija në bregdet (skele) në limanin e destinimit. Në rastin kur palët kontraktuese dëshirojnë që në obligimet e shitësit t'i përfshijnë edhe shpenzimet dhe rreziqet në lidhje me manipulimin me mall, nga skelja detare deri në magazinë dog. terminal, në lima ose jashtë tij, do të duhej të përdoret pariteti me termin DDU ose DDP.

Shitësi Transportuesi Kufiri Porti Porti Dogana Blerësi



DEQ

TERMA

DDU
DELIVERED
DUTY UNPAID
(...named place
of destination)

KUPTIMI


LIVRUAR
PAZHDOGANIM
(...vendi i
destinimit)

KOMENTIMI

Shitësi është i obliguar t'i bart të gjitha pagesat dhe rreziqet lidhur me livrimin e mallit deri në vendin destinatar kontraktuar i nues duke i përjashtuar "tagrat" që në këtë kontekst do ta përfshinin përgjegjësinë dhe rreziqet për kryerjen e formaliteteve doganore si dhe pagesat për to.

Në rastin kur palët kontraktuese pajtohen që shitësi t'i kryej të gjitha formalitetet doganore duke i paguar njëkohësisht edhe tagrat importuese kjo duhet të qartësohet me kontratë të shtitëblerjes.

Ky paritet mund të përdoret për të gjitha llojet e transportit, por në qoftë se malli livrohet në limanin e destinimit, në mjetin lundrues ose në bregdet do të duhej të përdoret pariteti me termin DES ose DEQ.



TERMA

DDP
DELIVERED
DUTY PAID
(...named place
of destination)

KUPTIMI

LIVRUAR
ME ZHDOGANIM
(...vendi i
kontraktuar i
destinimit)


KOMENTIMI


Shitësi ia livron mallin blerësit në vendin e përcaktuar me kontratë, të të zhdoganuar në import, të pashkarkuar nga mjeti i arritur i transportit. Shitësi i bart të gjitha shpenzimet dhe rreziqet lidhur me livrimin e mallit deri te vendi i përcaktuar me kontratë duke i përfshi (kur kjo është e mundur) edhe të gjitha tagrat e importit në vendin e destinacionit.

Në qoftë se palët kontraktuese dakor dohen që shitësin ta përjashtojnë nga disa obligime, që paguhen në proced. të importit, kjo duhet saktësuar në kontratën e shitëblerjes.

Paritetin me këtë term nuk do të duhej aplikuar në rastet kur shitësi nuk mundet me e siguruar lejën për import të mallit në mënyrë direkte ose të tërthortë.

Pariteti në fjalë mund të përdoret në të gjitha llojet e transportit por nëse malli livrohet në vendin destinues në lima ose (skele që lidhë ujin me tokë) duhet përdorur pariteti DES.





Grupet themelore - obligimet e shitësit

- Ex** works - FRANCO FABRIKA
- Free** - FRANCO
- Carriage** - TRANSPORTI
- Delivered** - E DORËZUAR

Shitësi
Shpenzimet dhe risku

Blerësi
Shpenzimet dhe risku

■ Kontakti

Për më shumë detaje lidhur me ndonjë procedure të caktuar ju lutem na kontaktoni në numrat e mëposhtëm:

Tel: +381 38 540 350,
+381 38 543 432,
+381 38 542 411,

Fax: +381 38 542 065




INCOTERMS Incoterms 2000

Rules at the core



Incoterms help to
one a
are m
cont

■ Pikëkalimet kufitare



Dogana e Kosovës
Bulevardi Bill Clinton p.n.
10.000 Prishtinë
Republika e Kosovës ,
hq@dogana-ks.org
www.dogana-ks.org